

VENDIM Nr. 273, datë 12.5.2021

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1088, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE TË PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT DHE PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE PËR PRONARËT PËRFITUES, SI DHE TË NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE DHE NGA SUBJEKTET E DETYRUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 6, pikat 8, 9, e 10, dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës "b", të pikës 1, të kreut I, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) "Kërkesa" është aplikimi që i drejtohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për kryerjen e veprimeve në regjistrin, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues."

2. Kudo në vendim, fjala "... Aplikim ..." zëvendësohet me "... Kërkesë ...".

3. Pika 9, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Procedura e regjistrimit fillestar nga subjektet raportuese ekzistuese të të dhënave për pronarët e tyre përfitues realizohet sipas parashikimeve të këtij kreu dhe sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues. Subjektet raportuese ekzistuese, të cilat rezultojnë me status të pezulluar në regjistrin tregtar, regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarit përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në regjistrin tregtar. Ndryshimi i statusit të subjekteve raportuese ekzistuese në regjistrin tregtar kryhet pas verifikimit se është regjistruar pronari përfitues i tyre, në regjistrin e pronarëve përfitues."

4. Shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 1, të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"c) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i" dhe "iii", të shkronjës "a", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit fillestar të subjekteve raportuese në regjistrat përkatës.

ç) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i" dhe "iii", të shkronjës "b", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda të njëjtit afat të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 5, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar ne F.Zyrtare 73/2021

Dale nga shtypi 17.05.2021